









Mirë se vini në javën e katërt të Adventit! Skena jonë e Lindjes së Krishtit po mbushet mjaft, por kemi disa njerëz më të rëndësishëm për të përfshirë! Këtë javë do të shtojmë engjëjt dhe barinjët dhe do të mësojmë rreth dashurisë.

Cilat janë disa mënyra se si mund t'u tregoni dashuri të tjerëve? Kur mendoni për dashurinë dhe si t'i tregoni dashuri dikujt tjetër, mund të mendoni për dhënien e një dhurate, ndihmën ndaj dikujt për të bërë një detyrë ose kalimin e kohës me atë person. Ndoshta doni të ndani diçka shumë të rëndësishme me atë person. Këto janë të gjitha gjëra të zakonshme që bëjmë gjatë sezonit të Krishtlindjeve. Zoti na tregoi dashurinë e Tij duke dërguar birin e Tij në botë. Foshnja e vogël që po festojmë u rrit dhe vdiq në kryq për ju dhe mua dhe për të gjithë në botë. Engjëjt ndanë lajmin e mirë të lindjes së Jezusit me barinjët. Si mund ta ndani lajmin e mirë për Jezusin? Si mund ta praktikoni dashurinë në një mënyrë që i afron njerëzit me Zotin ose i inkurajon ata?

Epo, aktiviteti ynë për këtë javë mund t'ju japë disa ide! Më poshtë do të shihni një listë aktiviteteesh që mund të bëni, së bashku me familjen ose kishën tuaj për të treguar dashuri ndaj të tjerëve përreth jush. Pra, zgjidhni të preferuarat tuaja dhe filloni t'i doni ata përreth jush!



KALEIDOSKOPI ADVENTIT

Kaleidoskopi për Sezonin e Adventit/Ardhjes është shumë i veçantë; në fakt, nuk është një kaleidoskop. Është një Skenë e Lindjes së Krishtit .

Në shumë vende të botës ekziston tradita e vendosjes së këtyre skenave si një mënyrë e rëndësishme për t'u përgatitur për Krishtlindje. Në vende të tjera, kjo nuk është një aktivitet i njohur.

Këtë vit, ne do të krijojmë një skenë të lindjes së Krishtit, duke shtuar një element të ri çdo javë. Për javën e parë të Adventit, krijuam vendin ku lindi Jezusi. Javën e dytë, shtuam kafshët në skenë. Javën e kaluar shtuam Marinë dhe Jozefin. Këtë javë po shtojmë engjëjt dhe barinjtë. Engjëjt erdhën për të shpallur lajmin e mirë se Jezusi kishte lindur, dhe barinjtë ishin njerëzit e parë që dëgjuan këtë Lajm të Mirë!

Printojeni këtë faqe dhe ngjyrosni engjëjt dhe barinjtë. Mund të keni secili nga sa të dëshironi. Madje mund të shtoni copa pëlhere të ndryshme për rrobat e tyre, fije leshi për flokët e tyre dhe ndoshta edhe pak shkëlqim për ti bërë engjëjt të shkëlqejnë. Pastaj ngjitini ato në karton. Ndhimojini barinjtë të qëndrojnë drejt duke shtuar dy copa kartoni në formë L-je dhe duke i ngjitur me shirit ngjitës në pjesën e prapme . Nëse doni që engjëjt të duken sikur po fluturojnë në qiell, mund të merrni një copë më të madhe kartoni dhe ta dekoroni që të duket si qielli, pastaj ngjitini engjëjt mbi të. Vendosni qiellin pas skenës së lindjes së Krishtit dhe shtoni barinjtë pranë kafshëve.

